Në bazë të nenit 25 paragrafit (8) të Ligjit për Arsim Profesional dhe Trajnim („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 3/25, 74/25 dhe 111/26), ministrja e Arsimit dhe Shkencës përcaktoi

RREGULLORE

për ndryshimin e Rregullores për mënyrën e realizimit të trajnimit për mentor, përcaktimin e përmbushjes së normave dhe standardeve për organizimin e trajnimit për mentor, si dhe formën dhe përmbajtjen e certifikatës për përfundimin e trajnimit për mentor

Neni 1

Në Rregulloren për mënyrën e realizimit të trajnimit për mentor, përcaktimin e përmbushjes së normave dhe standardeve për organizimin e trajnimit për mentor, si dhe formën dhe përmbajtjen e certifikatës për përfundimin e trajnimit për mentor, nr. 18-16168/1, të datës 24.12.2025, në nenin 4, paragrafin 2 shlyhet.

Neni 2

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e sjelljes së saj.

nr. 18-13006/3
19.10.2026
Shkup

Ministre e Arsimit dhe Shkencës,
проф. д-р Весна Јаневска, с.р.